



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

Procesverbal

i mbajtur më 19 qershor 2026, në mbledhjen Solemne të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VIII, për nderë të Shënimit të 19 Qershorit - Dita e Çlirimit të Podujevës

Mbledhja filloi në orën 11:20 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës. Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit.

Në mbledhje të pranishëm ishin anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës:

Nga LVV: Artrit Mulliqi; Fatri Zhitija; Valdet Kamerolli; Arbrim Kunushefci; Flandra Kadriu; Abedin Zeka; Ardi Hasani; (Munguan: Adelina Stublla; Kasib Bashota; Florent Hasani; Luljeta Muçolli-Azemi; Vlora Jashanica; Haki Rudari; Avni Islami).

Nga LDK: Enis Shabani; Enis Dervisholli; Besim Latifi; Valdet Restelica; Blerta Azemi-Berisha; Valon Demolli; Ekrem Rrahmani; Ermal Osmani; Arben Xhemajli; Isak Ejupi. (Munguan: Alisa Jetullahu; Gresa Qosa-Maçastena; Arnisa Sylejmani).

Nga PDK: Isak Shabani-Kryesuesi i Kuvendit; Lulzim Pollomi; (munguan: Mimoza Abdullahu; Rinesa Goxhufi).

Nga Guxo: mungoi Demokrat Hodolli.

Nga Unioni i Blakçorëve-UB: Gentrit Arifi.

Nga AAK: Baki Feta i cili mungoi.

Të pranishëm nga Ekzekutivi i Komunës ishin: z.Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës, z.Fahri Restelica Nënkyetari i Komunës;

U.D. drejtorët e Drejtorive të Komunës dhe atë: Arbnorë Uka Osmani-Drejtoria e Buxhetit dhe Financave DBF; Lirie Hoti Rama-Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS; Ahmet Ahmeti-Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit DPUMM; Valbona Azemi-Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit DKRS; Bahri Selimi-Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit DSHPMSh; Vigan Salihu-Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE;

Të pranishëm tjerë ishin: znj.Saranda Bogujevci Ministre e Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit në Qeverinë e Republikës së Kosovës; z.Kadri Kastrati ish Komandant dhe Gjeneral i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Zonën Operative të Llapit; z.Rafet Llapashtica, z.Xhemshit Gashi, z.Florim Statovci, z.Samet Arifi nga Shoqatat e Dala nga Lufta e UÇK-së dhe luftëtar të UÇK-së; Familjar të Heronjve dhe Dëshmorëve të Kombit; Ali Ajeti, Ilir Konushevc, Naim Kadriu, Ali Potera, Mirsad Gashi, Ilir Maloku, e të tjerë.

Media Lokale TV-Llapi, Radio Vizioni, dhe një numër i zyrtarëve komunale.

Hapja dhe kryesimi i mbledhjes

z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen, duke i'u dëshiruar të pranishmëve mirëseardhje në këtë mbledhje Solemne për nder të shënimit të 19 Qershorit - Dita e Çlirimit të Podujevës, dhe njëkohësisht i ftoi që fillimisht të ngrihemi në këmbë për ta respektuar intonimin e Himnit Kombëtar dhe atij Shtetëror.

Mbledhja u hap me Intonimin e Himnit të Republikës së Kosovës dhe Himnit të Republikës së Shqipërisë-Himni Kombëtar

z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit, vazhdoi, të nderuara Familje të Dëshmorëve, Invalidë dhe Veteranë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të nderuar përfaqësues të Shoqatave të dala nga Lufta, z.Rafet Llapashtica, z.Flortim Statovci, z.Bekim Zhdredha dhe z.Xhemshit Gashi, i nderuari Gjeneral Kadri Kastrati ish zëvendëskomandant i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për Zonën Operative të Llapit dhe ish komandant i Forcës së Sigurisë së Kosovës, i nderuari Kryetar i Komunës z.Shpejtim Bulliqi, i nderuari Nënkryetar i Komunës z.Fahri Restelica, e nderuara Ministre / Deputete znj.Saranda Bogujevci, të nderuar përfaqësues të Bashkësisë Fetare, të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës, drejtor të Drejtorive komunale, përfaqësues të media, si dhe përshëndetje të veçantë për përfaqësuesit e KFOR që me prezencën e tyre na ka nderuar, të nderuar të pranishëm, zonja dhe zotërinj, mirë se keni ardhur në këtë mbledhje solemne të Kuvendit të Komunës së Podujevës kushtuar përvjetorit të çlirimit të Podujevës.

Në bazë të agjendës së paraparë dhe në përputhje me përgjegjësitë tona institucionale e shpall të hapur këtë mbledhje solemne të Kuvendit të Komunës kushtuar shënimit të 19 Qershorit - Ditës së Çlirimit të Podujevës.

Kjo mbledhje solemne organizohet për nderim të sakrificës sublime të Dëshmorëve dhe Martirëve të Kombit, për të kujtuar Ditën e Çlirimit të Podujevës dhe për të riafirmuar përkushtimin tonë ndaj vlerave të lirisë, shtet ndërtimit dhe dinjitetit kombëtar, andaj të nderuar të pranishëm, ju ftoj që të ngrihemi në këmbë dhe të mbajmë 1 minutë heshtje në nderim të gjithë Dëshmorëve dhe Martirëve të Kombit të rënë për lirinë e Kosovës.

Mbahet 1 minutë heshtje në nderim të të gjithë Dëshmorëve dhe Martirëve të Kombit, të rënë për lirinë e Kosovës.

Lavdi e përjetshme

1. Fjalë rasti nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

z.Isak Shabani, Kryesuesi i Kuvendit, në fjalën e rastit, theksoi, të dashur qytetarë dhe të nderuar të pranishëm, sot në këtë përvjetor të çlirimit të Podujevës, përulemi me respekt para të gjithë atyre që sakrifkuan për lirinë e Kosovës, sot flasim për çlirimin por para se të flasim për të, flasim për lirinë, por mbi të gjitha duhet ta kujtojmë çmimin e saj. Liria e Kosovës nuk erdhi si dhuratë, ajo erdhi përmes lotëve të nënave që përcollën bijtë e tyre pa e ditur nëse do t'i shihnin më, erdhi përmes dhimbjes familjeve që humben më të dashurit e tyre, erdhi përmes gjakut të Dëshmorëve që e deshën atdheun më shumë se jetën. Rruga drejt lirisë nuk ishte as e shkurtër as e lehtë, në vitet më të rënda të popullit tonë, politika paqësore e presidentit Ibrahim Rugova e mbajti gjallë çështjen e Kosovës në arenën ndërkombëtare dhe e shndërroi kërkesën për pavarësi në një kauzë të njohur botërisht, por kur

padrejtësia u bë ligj dhe dhuna u bë përditshmëri duke tentuar të shuajë çdo shpresë për liri, doli në skenë Ushtria Çlirimtare e Kosovës. U ngritën djemtë dhe vajzat më të mira të këtij kombi, u ngritën ata që nuk pranuan të jetonin në gjuhë, ata morën mbi supe fatin e popullit dhe i treguan botës se ka momente kur liria nuk kërkohet më me fjalë, por fitohet me sakrificë.

Për shqiptarët, lufta e UÇK-së mbetet një nga periudhat më të ndritshme të historisë sonë, në themelet e saj qëndrojnë kolosët e kombit si Adem Demaçi ndërgjegjja e gjallë e rezistencës Shqiptare dhe e sakrificës për liri, Adem Jashari komandanti legjendar i cili me familjen e tij u shndërrua në simbolin më të madh të flijimit për atdheun, si dhe heroi komandanti Zahir Pajaziti i cili me veprën dhe guximin e tij ndezi flakën e rezistencës çlirimtare duke frymëzuar breza të tërë luftëtarësh të lirisë. Podujeva, Llapi dhe Gollaku dhanë një kontribut të jashtëzakonshëm në këtë rrugëtim historik. Kjo Trevë nxori luftëtarë, dëshmorë, patriotë që i dolën zot të vendit në momentet më vendimtare. Emrat e tyre jetojnë përjetësisht në kujtesën tonë dhe në historinë e Kosovës. Prandaj sot kur ecim të lirë në rrugët e qytetit tonë duhet të kujtojmë se nën çdo hap tonin qëndron sakrifica e dikujt që nuk u kthye kurrë në shtëpi. Dhe pikërisht për këtë arsye emrat e dëshmorëve duhet të mos lexohen vetëm në përvjetorë, por të jetojnë në veprat tona çdo ditë sepse ata janë amaneti ynë, ata janë ndërgjegjja jonë.

Të dashur qytetarë, liria që gëzojmë sot është rezultat i sakrificës së mijëra burrave dhe grave, prandaj detyra jonë është që këtë liri ta forcojmë çdo ditë përmes demokracisë, zhvillimit dhe shtet ndërtimit. Në këtë ditë kujtimi nuk mund të mos përmendim ish drejtuesit politik dhe ushtarak të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që po përballen padrejtësisht në proceset gjyqësore, Presidenti Hashim Thaçi, kryetarët e Kuvendit Jakup Krasniqi dhe Kadri Veseli, deputeti Rexhep Selimi dhe bashkëluftëtarët tjerë. Kontributi dhe sakrifica e tyre për lirinë e Kosovës mbetet pjesë e pandashme e kujtesës sonë kolektive, ndërsa besimi ynë në të vërtetën, drejtësinë dhe vlerat për të cilat ata luftuan, mbetet i pa lëkundur.

Ata që fyejnë vlerat e UÇK-së nuk po sulmojnë vetëm një emër apo një simbol, por po prekin sakrificën e mijëra burrave e grave që dhanë gjithçka për lirinë e këtij vendi, shpesh më së shumti flasin e gjykojnë ata që nuk kanë përjetuar peshën e asaj kohe. Më dhimbshme se vetë fyerja është mosmirënjohja. Ka njerëz që sot gëzojnë frytet e lirisë, por harrojnë sakrificën të cilën e me të cilën u ndërtua ajo, ata ecin të lirë, flasin të lirë, jetojnë të lirë, por nuk gjejnë respekt për ata që paguan çmimin më të lartë për këtë liri. Mos mirënjohja dhe sakrifica nuk e ndryshon historinë, po tregon varfëri në kujtesë dhe ndërgjegje.

Të nderuar të pranishëm, përvjetori i çlirimit të Podujevës është ditë krenarie, por edhe ditë përgjegjësie. Përvjetorët si ky na kujtojnë se historia nuk duhet harruar, por as të mbetemi peng i saj, ne duhet të frymëzohemi nga e kaluara për të ndërtuar të ardhmen, brezat të rinj duhet ta njohin çmimin e lirisë dhe të kuptojnë se ajo është e fituar me sakrifica të mëdha, me guxim dhe me përkushtim ndaj atdheut.

Faleminderit të veçantë për miqtë tanë ndërkombëtarë për mbështetjen dhe ndihmën e dhënë në rrugën tonë drejt lirisë, mirënjohja do të mbetet e përhershme për ta, prandaj le të mos harrojmë kurrë se kush nderon të kaluarën, ndërton të ardhmen.

Dhe në fund më lejoni ta mbyll fjalën time me një fjalë që duhet kujtuar gjithmonë. Ne jetojmë të lirë nga sakrifica e atyre që na lanë lirinë trashëgim.

Lavdi gjithë Dëshmorëve të Kombit, nderim për të gjithë ata që sakrifkuan për lirinë.

Urime përvjetori i çlirimit të Podujevës. Ju faleminderit.

Tani kam nderin t'ia jap fjalën Kryetarit të Komunës zotëri Shpejtim Bulliqi.

2. Fjalë rasti nga Kryetari i Komunës së Podujevës

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, faleminderit i nderuar Kryesues i Kuvendit të Komunës z.Isak Shabani, i nderuari Nënkryetar i Komunës së Podujevës z.Fahri Restelica, e nderuara Ministre e Ministrisë së Kulturës Rinis dhe Sportit dhe Deputete e Parlamentit të Republikës së Kosovës znj.Saranda Bogujevci, i nderuari Gjeneral Kadri Kastrati, të nderuara Familje të Dëshmorëve, Veteran dhe Invalid të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të nderuar asambleistë/e, të ndërtuar përfaqësues të KFOR, Media të respektuara, zonja dhe zotërinj.

Sot shënojmë me krenari, respekt dhe mirënjohje 27 vjetorin e Çlirimit të Podujevës, një nga datat më të rëndësishme në historinë e Komunës sonë dhe në kujtesën e çdo qytetari të Llapit dhe Gollakut. 19 Qershori na kujton rrugën e gjatë dhe të vështirë drejt lirisë, sakrificat e panumërta të popullit tonë dhe heroizmin e atyre që dhanë gjithçka për atdheun.

Liria që gëzojmë sot është vepër e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e Dëshmorëve, Martirëve dhe e të gjithë atyre që nuk u dorëzuan kurrë përballë padrejtësisë dhe shtypjes.

Në këtë rrugëtim historik vendimtar ishte edhe mbështetja e aleatëve tanë dhe ndërhyrja e NATO-s kundër regjimit serb. Për këtë, populli i Kosovës do të jetë gjithmonë mirënjohës ndaj vendeve mike, në veçanti ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të cilat qëndruan në anën e drejtë të historisë kur populli ynë kishte më së shumti nevojë.

Llapi ka qenë gjithmonë në ballë të përpjekjeve për liri dhe shtet ndërtim. Kjo Trevë krenare i dha Kosovës bijë e bija që u bënë simbol i rezistencës, i guximit dhe i atdhedashurisë. Emrat e Komandantit Zahir Pajaziti, Hakif Zejnullahu, Ilir Konushevi, Ali Ajeti, Afrim Zhitia, Bahri Fazliu, Ylfete Humolli, bacës Adem Demaçi, Fadil Vokrrit dhe shumë personaliteteve të tjera do të mbeten përherë pjesë e krenarisë sonë kombëtare dhe frymëzim për brezat që vijnë.

Sot, 27 vjet pas çlirimit, ne kujtojmë me respekt të thellë të gjithë ata që sakrifikuan për lirinë tonë, kujtimi për ta nuk është vetëm nderim për të kaluarën, por edhe obligim për të ardhmen, është detyrë e secilit prej nesh që ta ruajmë dhe ta forcojmë shtetin për të cilin ata luftuan dhe u sakrifikuan.

Amaneti i Dëshmorëve përmbushet duke punuar çdo ditë për një Podujevë më të zhvilluar, më të fortë dhe më të mirë për qytetarët tanë, si dhe për një Kosovë gjithnjë e më të përparuar, të drejtë dhe të suksesshme në rrugën e saj euroatlantike. Në këtë ditë të shënuar, përulemi me respekt para veprës së tyre dhe ritheksojmë se liria mbetet vlera më e çmuar që kemi trashëguar.

Lavdi të përjetshme Dëshmorëve dhe Martirëve të lirisë, lavdi Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Zoti e bekoftë Podujevën, Kosovën dhe krejt Shqiptarët. Ju faleminderit

Kryesuesi i Kuvendit, duke falënderuar Kryetarin e Komunës për fjalën e rastit, theksoi, tani ftoj për një fjalë rasti përfaqësuesin e LDK-së në Kuvendin e Komunës.

3. Fjalë rasti e përfaqësuesit të Grupit të LDK-së në Kuvendin e Komunës.

z.Besim Latifi, theksoi, të nderuar përfaqësues të institucioneve, të nderuara Familje të Dëshmorëve dhe Martirëve të Kombit, të nderuar gjeneral, komandant, veteran dhe invalid të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nga Zona Operative e Llapit, të nderuar qytetarë të Podujevës, zonja dhe zotërinj.

Sot jemi mbledhur për të shënuar datën më të rëndësishme në historinë e Podujevës dhe të Llapit, 19 Qershorin-Ditën e Çlirimit. 19 qershori i vitit 1999 shënon fundin e një periudhe të gjatë vuajtjesh dhe fillimin e epokës së lirisë, ishte dita kur triumfoi e drejta mbi padrejtësinë, shpresa mbi frikën dhe dinjiteti njerëzor mbi dhunën e pushtuesit. Kjo liri nuk erdhi rastësisht dhe as si dhuratë, ajo u fitua me sakrificën më të madhe që mund të japë një popull, me jetën e bijve dhe bijave të tij më të mira. Prandaj, sot përulemi me respekt dhe mirënjohje të përvetshme para Heronjve, Dëshmorëve dhe Martirëve të Kombit tonë, si dhe para familjeve që bartën dhe vazhdojnë të bartin peshën e kësaj sakrifice me krenari e dinjitet.

Të nderuar të pranishëm, Llapi ka qenë ndër vatrat më të fuqishme të qëndresës Shqiptare, kjo trevë ka nxjerrë brez pas brezi luftëtarë që zgjodhën lirinë para nënshtimit dhe sakrificën para heshtjes. Me krenari kujtojmë Heroin e Kombit Zahir Pajaziti, themeluesin dhe komandantin e parë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Heroin Hakif Zejnullahu, bashkëluftëtarin e tij të pandarë, si dhe Heroin Ilir Konushevi një nga figurat kyçe të organizimit dhe të furnizimit të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Rrënjët e qëndresës së Llapit janë edhe më të hershme, kujtojmë Heroin Ali Ajeti dhe të gjithë luftëtarët e brezave të ndryshëm që mbajtën gjallë idealin e lirisë, secili prej tyre zë një vend të përhershëm në historinë tonë Kombëtare. Rruga drejt lirisë ishte e gjatë dhe e vështirë, ishin vitet kur popullit tonë i mohoheshin të drejtat themelore, kur mbylleshin shkollat dhe universitetet dhe kur synohej të shuhet identiteti jonë kombëtar. Në ato rrethana, Kosova ndërtoi rezistencën e saj politike dhe qytetare nën udhëheqjen e Presidentit Historik Doktor Ibrahim Rugova i cili me vizion, urtësi dhe vendosmëri, organizoi rezistencën paqësore, mbrojt funksionimin e arsimit shqip ndonëse na larguan nga objektet shkollore arsimi vazhdojë në shtëpi-shkolla.

Rugova e bëri çështjen e Kosovës pjesë të ndërgjegjes ndërkombëtare, ai ndërtoi orientimin e qartë përëndimor të Kosovës dhe krijoi miqësinë strategjike me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, miqësi që mbetet një nga themelet më të rëndësishme të shtetit tonë, prandaj historia e lirisë së Kosovës nuk mund të kuptohet pa dy shtyllat e saj kryesore: vizionin politik të Ibrahim Rugovës dhe luftën çlirimtare të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Të dyja së bashku e bënë të mundur lirinë dhe shtetësinë që e gëzojmë sot.

Në këtë ditë të shenjtë, shprehim mirënjohjen tonë të thellë për Shtetet e Bashkuara të Amerikës, NATO-n dhe të gjithë aleatët tanë demokratikë, të cilët në momentet më kritike u rreshtuan në anën e drejtë të historisë dhe ndaluan spastrimin etnik të Kosovës dhe përmes bombardimit ajror dhe ndërhyrjes tokësore e bënë të mundur çlirimin e Kosovës.

Të nderuar qytetarë, 19 Qershori nuk është vetëm një ditë feste, është ditë kujtesës së madhe, është ditë reflektimi të thellë, mbi të gjitha, është ditë e përgjegjësisë sonë shtetërore, sepse liria nuk është një akt që përfundon me fitimin e saj, liria duhet të ruhet, të mirëmbahet dhe të kultivohet çdo ditë. Ajo ruhet duke vendosur drejtësinë, ruhet duke ndërtuar një shtet të fortë, ligjor dhe të zhvilluar ekonomikisht, ruhet duke arsimuar e punësuar rininë tonë në tokën e tyre, ruhet me unitet kombëtar përballë çdo sfide që na kanoset, dhe mbi të gjitha, liria ruhet duke respektuar e nderuar, pa asnjë kompromis, sakrificën e atyre që dhanë jetën për këtë vend.

Të dashur Llapjanë, historia jonë është e lavdishme, e ardhmja jonë duhet të jetë po aq e denjë sa sakrifica e atyre që na sollën lirinë.

Zoti e bekoftë Podujevën, Llapin dhe Republikën e Kosovës.

Urime Dita e Çlirimit! Qofsh përherë e lirë dhe krenare Podujevë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, të nderuar të pranishëm, tani kam nderën dhe kënaqësinë t'i jap fjalën një personaliteti të shquar, i cili ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në luftën për i ri dhe në ndërtimin e institucioneve të sigurisë së Kosovës. Ai erdhi nga mërgata për t'u bashkuar radhëve të UÇK-së duke vënë në shërbim të atdheut përvojën, përgatitjen dhe përkushtimin e tij.

Gjatë luftës u emërua zëvendës komandant i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për Zonën Operative të Llapit, duke dhënë një kontribut të rëndësishëm për çlirimin e Podujevës dhe Kosovës.

I diplomuar në Akademi ushtarake dhe me formim të lartë profesional, ai vazhdoi t'i shërbejë vendit edhe pas luftës. Andaj duke u bazuar në angazhimin, profesionalizmin dhe lidhshërinë e tij u zgjodh Komandant i Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Zotëri gjeneral, tani foltorja është ju, urdhëroni me një fjalë rasti.

4. Fjalë rasti e përfaqësuesit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës - Zona Operative e Llapit

z.Kadri Kastrati, ish zëvendës Komandant i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe Komandant i Forcës së Sigurisë së Kosovës, theksoi, i nderuari Kryetar i Komunës së Podujevës, Nënkyetar i Komunës, e nderuara Ministre, drejtor të pranishëm të Drejtorive, të pranishëm asambleistë të Kuvendit të Komunës së Podujevës, zotëri Isak Shabani Kryesues i asamblesë komunale, të nderuar pranishëm, të nderuara dhe shumë të respektuara Familje të Dëshmorëve, Invalid dhe Veteran të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, zonja dhe zotërinj. Sot jemi mbledhur me krenari, respekt dhe emocione të veçanta për të shënuar ditën e çlirimit të Podujevës, një nga datat më të rëndësishme në historinë e qytetit tonë. Kjo është dita kur liria triumfoi mbi pushtimin, kur shpresa fitoi mbi frikën dhe kur sakrifica e popullit tonë u kurorëzua me çlirim.

Në këtë ditë para së gjithash përkulemi me nderimin më të thellë para Dëshmorëve të Kombit, Martirëve, luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe të gjithë atyre që dhanë kontribut në rrugën e gjatë dhe të vështirë drejt lirisë. Ata nuk kursyen as jetën e tyre për idealin më të madh, Kosovën e lirë dhe të pavarur.

Podujeva dhe Llapi kanë qenë gjithmonë vatër e qëndresës kombëtare, kjo Trevë ka nxjerrë burra e gra të cilët në çdo periudhë historike i dolën zot atdheut, sikur Adem Demaçi, Zahir Pajaziti, Ilir Konushevci dhe shumë e shumë dëshmorë të tjerë.

Nga kryengritjet e hershme për liri, te rezistenca kundër padrejtësive dhe deri te lufta e fundit çlirimtare, Llapi ka qenë në ballë të përpjekjeve për liri dhe dinjitet kombëtar. Gjatë luftës së viteve 1998-1999 qytetarët e Podujevës përjetuan vuajtje të mëdha, familje të tëra u dëbuan nga shtëpitë e tyre, shumë civil të pafajshëm u vranë ndërsa fshatra e lagje të tëra u shkatërruan, megjithatë populli ynë nuk u dorëzua, përkundrazi, ai gjeti forcën për të vazhduar rezistencën dhe për të mbështetur luftën çlirimtare deri në fitoren përfundimtare. Në këtë rrugëtim historik doli Ushtria Çlirimtare e Kosovës, ishte vendimtare, luftëtarët e saj të mbështetur nga populli u bënë simbol i qëndresës dhe i aspiratës shekullore për liri. Emrat e Dëshmorëve tanë do të mbeten gjithmonë të gdhendur në historinë e Kosovës dhe në zemrat tona. Po ashtu sot shprehim mirënjohje për të gjithë miqtë tanë dhe aleatët ndërkombëtarë që mbështeten kauzën e drejtë të popullit të Kosovës. Ndërhyrja e natës shënoi një kthesë historike që i dha fund vuajtjeve dhe hapi rrugën drejt lirisë dhe ndërtimit të institucioneve demokratike.

Të nderuar të pranishëm, liria nuk është vetëm një kujtim i lavdishëm, ajo është edhe përgjegjësi, përgjegjësi për të ndërtuar një shoqëri më të drejtë, më të zhvilluar dhe më të bashkuar. Brezat që vijnë duhet të mësojnë se liria që gëzojmë sot është fituar me gjak, sakrificë dhe përkushtim të jashtëzakonshëm. Detyra jonë është që të ruajmë kujtesën historike, të nderojmë Dëshmorët jo vetëm

me fjalë, por edhe me punë konkrete për të mirën e vendit. Ne duhet të ndërtojmë një Podujevë më të zhvilluar, një llap më të fortë dhe një Kosovë më të begatë, ku të rinjtë shohin të ardhmen e tyre dhe ku vlerat për të cilat u sakrifikua të mbrohen dhe të forcohen çdo ditë.

Sot, ndërsa kujtojmë të kaluarën tonë të lavdishme, le të shikojmë me besim drejt së ardhmes, le të punojmë së bashku për një Kosovë më të fortë, më të sigurt dhe më të zhvilluar, le të mbetemi të bashkuar rreth idealeve të lirisë, demokracisë dhe shtet ndërtimit.

Në këtë ditë të shenjtë për Podujevën dhe gjithë Kosovën, përulemi me respekt para veprës së pavdekshme të Dëshmorëve tanë.

Lavdi e përjetshme Dëshmorëve të Kombit, nderim për Veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Urime Dita e Çlirimit të Podujevës, urime Llapit. Ju faleminderit.

Kryesuesi i Kuvendit, falënderoj parafolësin për fjalën rasti, vazhdoi, Kryetari i Shoqatës së Veteranëve zotëri Rafet Llapashtica në emër të Shoqatës ka përgatitur tri mirënjohje për kontributin e dhënë në luftën për çlirim, të cilin e ftojme për ndarjen e tyre.

z.Rafet Llapashtica, Kryetari i Shoqatës së Veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, theksoi, ju faleminderit i nderuar Kryesues i Kuvendit, i nderuari Kryetar i Komunës z.Shpejtim Bulliqi, Nënkryetar i Komunës z.Fahri Restelica, përfaqësues të institucioneve qendrore e lokale, asambleistë të nderuar, shumë të respektuar e nderuar Familje të Dëshmorëve, përfaqësues të Organizatës së Dëshmorëve, Invalidëve, media, qytetarë të nderuar, urime Dita e Çlirimit, një prej datave më të rëndësishme të Komunës tonë.

Në bazë të vendimit 01-7/26 për dekorimet dhe mirënjohjet e luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të Organizatës së Degës së Veteranëve në Podujevë, Organizata nderon sot 3 luftëtarë, dy prej tyre post-mortum dhe 1 luftëtar të gjallë për kontributin e dhënë për lirinë dhe këto do të vazhdojnë në datën e pasim. Kështu që ftoj Kryetarin e Komunës zotëri Shpejtim Bulliqi dhe gjeneral Kadri Kastratin që së bashku t'i ndajmë mirënjohjet.

Nga z.Rafet Llapashtica, Kryetari i Komunës z.Shpejtim Bulliqi dhe z.Kadri Kastrati, ndahen mirënjohje për kontributin e dhënë për liri, dhe atë:

Fillimisht ftohet përfaqësuesi i familjes së ish luftëtarit të lirisë Ali Poterta për pranimin e Mirënjohjes/Dekoratës post-mortum për kontributin e dhënë për liri.

(Mirënjohje / Dekoratë të cilën e pranoi Dardan Potera, djali i të ndjerit)

Në vazhdim ftohet përfaqësuesi i familjes së ish luftëtarit dhe siç theksohet bashkëveprimtarit Naim Kadriu njëri prej luftëtarëve të shquar të UÇK-së, për pranimin e Mirënjohjes/Dekoratës post-mortum për kontributin e dhënë për lirin e Kosovës.

(Mirënjohje/Dekoratë të cilën e pranoi Kosovar Kadriu, djali i të ndjerit)

z.Rafet Llapashtica, në vazhdim theksoi, për kontributin në luftë, përkujdesjen e luftëtarëve, për shërimin e plagëve dhe kontributin e jashtëzakonshëm në rrethana të jashtëzakonshme, ndajmë Mirënjohje për luftëtarin dhe doktorin z.Skënder Murati i cili sot nuk ka mund të jetë këtu për arsye se vazhdon misionin dhe ka qenë në një intervenim kirurgjik. Kështu që Organizata është dakorduar që mirënjohjen ta pranojë, dhe ftoj Sekretarin e Organizatës të merr Mirënjohjen / Dekoratën në fjalë dhe në një momentum të caktuar t'ia dorëzojmë doktorit në fjalë për arsye se është në shërbim në Qendër Klinike Universitare të Kosovës.

(Mirënjohje të cilën e pranoj z.Florim Statovci Sekretar i Organizatave të Dala nga Lufta e UÇK-së, e cila mbetet që në një momentum të përshtatshëm t'ia dorëzojë z.Skender Muratit)

Pas kësaj ceremonie, zotëri Llapashtica falënderoi Kryesuesin e Kuvendit për hapësirën e mundësuar për ndarjen e këtyre Mirënjohjeve / Dekoratave në këtë mbledhje solemne.

Kryesuesi i Kuvendit, duke i falënderuar të pranishmit për pjesëmarrjen dhe për nderimin e bërë sot Ditës së Çlirimit të Podujevës dhe gjithë Dëshmorëve dhe Martirëve të Kombit, e shpall të mbyllur këtë mbledhje solemne të Kuvendit të Komunës.

Lavdi e përjetshme Dëshmorëve.

Ju faleminderit dhe mirë u pafshim.

Konstatohet e përfunduar kjo mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:50

**Procesverbalin e mbajti dhe hartoi;
Enis Sheholli**

**Nr.Prot.01-060/04-0035930/26
Podujevë, 19 qershor 2026**

**Kryesuesi i Kuvendit
Isak Shabani**